



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2148/8prot.

Datë 12.12.2022

**V E N D I M**  
**Nr. 1232/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Tërnova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.12.2022 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “INSIG” SHA si dhe vendimit mbi anulimin e procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-40047-08-26-2022, me objekt “Sigurim Automjetesh TPL”, për Komandën e Forcës Detare” me fond limit 4,091,349.00 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 08.09.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

**Ankimues:** “INSIG” SHA  
Rruga “Jul Varibova” nr. 21, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.  
Blv ”Dëshmorët e Kombit” Nd.1, 1001, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nwn kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 29.08.2022, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-40047-08-26-2022, me objekt “Sigurim Automjetesh TPL”, për Komandën e Forcës Detare” me fond limit 4,091,349.00 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 08.09.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 08.09.2022 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 27.09.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “INSIG” SHA

4.086.330 lekë, skualifikuar

Në datën 19.09.2022 operatori ekonomik “INSIG” SHA është njoftuar për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike për arsyet si më poshtë:

*OE nuk arriti që nepermjet pergjigjes nr. 1790/1 date 20.09.2022, te sqaroje me provat perkatese arsyet e krijimit te humbjeve financiare per secilin prej zerave te kerkuara te bilancit te vitit 2021, ashtu sic i ishte kerkuar me shkresen nr. 1457 date 13.09.2022 te AK. Bazuar ne nenin 77 pika 3 te LPP, OE per te garantuar se kane kapacitetin e nevojshem ekonomik dhe financiar per te zbatuar kontraten, duhet te japin informacione ne bilancet e tyre qe tregojne raportet ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit. Persa me siper, bazuar edhe ne nenin 43 pika 4 dhe 6 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ne mungese te informacionit dhe provave per arsyet e krijimit te humbjeve financiare te vitit 2021, ofertuesi nuk arriti te garantoje mundesine e permbushjes me sukses te kontrates objekt prokurimi.*

II.4. Në datën 28.09.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Publikimi i Njoftimit të anulimit” për procedurën e prokurimit.

II.5. Në datën 04.10.2022 operatori ekonomik “INSIG” SHA, ka paraqitur njëkohësisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike si dhe si dhe vendimit mbi anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.2148/2 prot., datë 05.10.2022 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “INSIG” SHA.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 1613 prot., datë 14.10.2022, protokolluar me tonën me nr. 2148/3 prot., datë 17.10.2022 me objekt “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt: “Sigurim Automjetesh TPL për Komandën Detare”, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues Nr.1551/2 prot., datë 13.10.2022, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik “INSIG” SHA.

II.8. Me shkresën nr. 2148/5prot. datë 04.11.2022 Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ku kërkon nga ana e institucionit të tyre informacion mbi bilancet/pasqyrat financiare të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues “INSIG” SHA në procedurën objekt shqyrtimi për vitet 2019-2020-2021, për të cilat kërkojnë informacion, nëse raporti nëpërmjet aktivitetit dhe pasivitetit është negativ apo jo?.

II.9. Me shkresën nr. 2148/6prot. datë 30.11.2022 Komisioni i Prokurimit Publik i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkresën me objekt kërkesë e përsëritur ku kërkon nga ana e institucionit të tyre informacion mbi bilancet/pasqyrat financiare të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues “INSIG” SHA në procedurën objekt shqyrtimi për vitet 2019-2020-2021, për të cilat kërkojnë informacion, nëse raporti nëpërmjet aktivitetit dhe pasivitetit është negativ apo jo?.

II.10. Me shkresën nr. 18913/1 prot., datë 01.12.2022 protokolluar me tonën nr. 2147/7prot., datë 05.12.2022 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve na informon ndërsa të tjera se administrata tatimore kontrollon vetëdeklarimin e tatim-paguesve në lidhje me përcaktimin e fitimit të tatueshëm, si dhe kjo e fundit nuk shpreh opinionë në lidhje me raportet nëpërmjet pasqyrave të bilancit.

II.11. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “INSIG” SHA, se arsyeja e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “*OE nuk arriti që nëpërmjet përgjigjes nr. 1790/1 date 20.09.2022, të sqarohet me provat përkatëse arsyet e krijimit të humbjeve financiare për secilin prej zerave të kërkuara të bilancit të vitit 2021, ashtu siç i ishte kërkuar me shkresën nr. 1457 date 13.09.2022 të AK. Bazuar në nenin 77 pikë 3 të LPP, OE për të garantuar se kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të japin informacione në bilancet e tyre që tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përsa me sipër, bazuar edhe në nenin 43 pikë 4 dhe 6 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në mungesë të informacionit dhe provave për arsyet e krijimit të humbjeve financiare të vitit 2021, ofertuesi nuk arriti të garantojë*

*mundesine e permbushjes me sukses te kontrates objekt prokurimi.*”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8,, “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë: *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “INSIG” SHA në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Pasqyrat Financiare për vitin 2019 të konfirmuara nga Administrata Tatimore
- Pasqyrat Financiare për vitin 2020 të pakonfirmuara nga Administrata Tatimore
- Pasqyrat Financiare për vitin 2021 të pakonfirmuara nga Administrata Tatimore

III.1.3. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

III.1.4. Neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

- Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.
- Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:
  - a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
  - b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;
  - c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.
- Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.
- **Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**
- Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.
- Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

III.1.5. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se

autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.6. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kushtin duke paraqitur **kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore** gjithashtu kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka **raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit**. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Insing sha në ditën e hapjes së ofertave në plotësim të këtij kriteri rezulton, se janë paraqitur pasqyrat financiare **për vitet përkatësisht 2019, 2020, 2021 të konfirmuara nga Administrata Tatimore**, ndërkohë autoriteti kontraktor në arsyen e skualifikimit ka argumentuar “[...] OE nuk arriti që nëpërmjet përgjigjes nr. 1790/1 datë 20.09.2022, të sqarojë me provat përkatëse arsyet e krijimit të humbjeve financiare për secilin prej zërave të kërkuara të bilancit të vitit 2021, ashtu sic i ishte kërkuar me shkresën nr. 1457 datë 13.09.2022 të AK[...]”. Në këtë kuptim, KPP gjykon se operatori ekonomik Insing ShA me dokumentacionin e paraqitur, kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2019, 2020, 2021), plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit pasi vet kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, ndërkohë që operatori ekonomik ankimues në procedurën objekt shqyrtimi ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike pasqyrat financiare për tre vite të ushtrimit të aktivitetit të tij financiaro ekonomik. Në rastin konkret Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Insing” sha me anë të dokumentacionit të paraqitur ka dëshmuar se zotëron kapacitetet financiare të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës referuar kjo edhe në parashikimet ligjore në të cilën parashikohet se [...] **Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.[...].**

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave

*Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

**Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Insing” SHA për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-40047-08-26-2022, me objekt “Sigurim Automjetesh TPL”, për Komandën e Forcës Detare” me fond limit 4,091,349.00 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 08.09.2022, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.
  2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Insing” SHA dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
  3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Insing” SHA.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Tërnova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**